

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS -PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i galerisë së pjerrët në HEC Koman, FV dekovili i ri dhe rikonstrukcion i sheshit mes galerisë së pjerrët dhe shpatit të djathtë në digën e Komanit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi -45210000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 90,435,579 (Nëntëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e pesëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) Lek, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor KESH sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P - 1/A Punime gjurmimi në tokë.
N.P - 2/A Ndërtime civile dhe industriale

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 1/A Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S - 11/C Punime mbi shina dhe traversa
N.S - 14/A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

Kategoritë e licensave “N.P dhe N.S” të janë hartuar në përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gjurmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës.

Kategoritë e licencave janë kërkuar referuar relacionit teknik, projekt zbatimit dhe preventivit, ku zbatimi i punimeve në mënyrë të përmbledhur përfshinë :

- ✚ *Puna për zbatimin e objektit do të fillojë me punimet e gjurmimit të dherave të cilat duhet të kryhen në nivelet dhe vijën e prerjeve si janë paraqitur në vizatime të cilat duhet të bëhen me kujdes të veçantë për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar për të mos sjell rrezikshmëri për qëndrueshmërinë strukturore;*
- ✚ *Punimet e ndërtimit civile dhe industriale referuar gjithë objektit të zbatimit i cili konsiston në punime ndërtimore rehabilituese;*

- ✚ Punime për prishjen e ndërtimeve referuar gjithë punimeve të prishjes dhe çmontimit të përcaktuar në këtë projekt.
- ✚ Punime mbi shina dhe traversa, referuar punimeve për vendosjen e impiantit dekovil dhe gjithë pajisjeve në funksion të tij.
- ✚ Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj., referuar punimeve të përcaktuar në këtë projekt.

Kategoritë A dhe C të kërkuara në këtë kriter, janë përcaktuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit të punimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoreshë prej minimalisht 35 (tridhjetë e pesë) punonjës për periudhën (Qershor 2024 - Gusht 2024):

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Qershor 2024 - Gusht 2024).

2.3.4 Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar personelin kryesor si Drejtues teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Qershor 2024 - Gusht 2024) stafi inxhinierik si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Ndërtimi,
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik,

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë,
- CV.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Qershor 2024 - Gusht 2024) stafin mbështetës si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) inxhinier elektrik
- ✚ minimalisht 1 (një) teknik ndërtimi,
- ✚ minimalisht 1 (një) elektrikist,
- ✚ minimalisht 2 (dy) mekanik
- ✚ minimalisht 1 (një) hekurthyes
- ✚ minimalisht 1 (një) karpentier
- ✚ minimalisht 3 (tre) specialist ndërtimi
- ✚ minimalisht 10 (dhjetë) punëtor të kualifikuar
- ✚ minimalisht 13 (trembëdhjetë) punëtor

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,

autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë / certifikatë

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve, si dhe specialitetet të cilat duhet të kenë këta punonjës është përcaktuar në raportin teknik të përgatitur nga projektuesi. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në staffin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Qershor 2024 - Gusht 2024) minimalisht 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë për “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Certifikatën e kualifikimit të kërkuar;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të

sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Në mënyrë që të mundësohet një siguri e plotë e punonjësve dhe ambientit të punës, punonjësit duhet të njihen me vlerësimin dhe pasojat rreziqeve, si dhe procedurat e punës, të ngarkuarit për sigurimin, pajisjet të tilla, që të garantojnë gjatë gjithë kohezgjatjes së punimeve respektimin e rregullave për parandalimin e demtimeve, e që garantojnë jetën e shëndetin e puntoreve. Gjatë zbatimit të punimeve duhet të respektohen me rigorozitet të gjitha kërkesat për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kushtet teknike si dhe praktikën me të mira. Përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, duhet të ndjek /monitorejë zbatimin e kërkesave ligjore dhe të sigurojë që i gjithë personeli të marrë trajnim të përshtatshëm për Sigurinë në punë. Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet, të cilat mund të lindin gjatë fazës së punimeve inxhinierike nga moszbatimi i rregullave të sigurisë në punë, nga mosmarrja e masave paraprake të sigurisë, kompania zbatuese në terren duhet të implementojë një sistem menaxhimi të shëndetit që përcaktohet për veprimtaritë ndërtimore sipas legjislacionit përkatës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001: "Sistemi i menaxhimit të cilësisë";
- b) ISO 14001: "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë dhe të paraqesë me anë të një deklaratë nga Administratori i shoqërisë **Drejtuesin Teknik të punimeve** në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese", si më poshtë:

- Deklaratën për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt;
- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë;

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” e ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa”.

Kriteri për drejtuesin teknik lidhet ngushtësisht objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.9 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për pajisjen dekovil. Në autorizim duhet të përcaktohet se gjitha makinat, shasia, sistemi i drejtimit, komponentët elektrikë dhe operacionalë do të sigurohen nga i njëjti Prodhues/distributor i autorizuar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesve ose distributorëve të autorizuar për pajisjen dekovil, është një dokument i rëndësishëm, i cili rrit sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka kjo pajisje për realizimin e projektit referuar preventivit të punimeve që parashikon projekti objekt kontrate.

Konkretisht: Në këtë projekt, dekovili është një sistem kompleks i cili ndër të tjera përmban pajisjen ngritëse (elektromotor, reduktor, sistem komandimi, sistem frenimi, etj), sistemin e shinave, mekanizmin që realizon lëvizjen në pjesën e kurbëzuar, kabinën e ashensorit, etj.

2.3.10 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët teknik për pajisjen dekovil në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të parashikuara.

Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të parashikuara në këtë projekt.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë nga prodhuesi se do të suportojë operatorin ekonomik me specialistë për montimin dhe kolaudimin e pajisjes dekovil.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo deklaratë do të ti japë sigurinë Ak-së mbi realizimin e punimeve të montimit dhe kolaudimit të pajisjes dekovil sipas parashikimeve të këtë projekt.

Konkretisht: Gjatë montimit të tyre në objektin përkatës, me qëllim garantimin e funksionalitetit të dekovilit është shumë e rëndësishme që të respektohen të gjithë kërkesat teknike të montimit sipas specifikimeve të prodhuesit dhe referuar kushteve reale të objektit. Gjithashtu duke qenë se dekovili është i parashikuar edhe për lëvizjen e personelit të HEC Koman në galerinë e pjerrët, një element i rëndësishëm është dhe aspekti i sigurisë së tij. Për këtë qëllim në projekt është kërkuar që dekovili veç sistemit të frenimit në pajisjen ngritëse të ketë dhe sistem frenimi emergjent në kabinën e ashensorit. Ky sistem frenimi në momentin e montimit dhe kolaudimit në objekt ka nevojë të regjistrohet/tarohet në bazë të provave me ngarkesë në gjatësi të ndryshme të galerisë. Një element tjetër i rëndësishëm është dhe mekanizmi që mundëson lëvizjen në pjesën e kurbëzuar të galerisë. Edhe ky mekanizëm pasi të montohet ka nevojë të regjistrohet/tarohet në objekt gjatë procesit të kolaudimit.

Nga sa më sipër, duke qenë se prodhuesi i dekovilit është njohësi më i mirë i teknologjisë së përdorur është e nevojshme që një përfaqësues i prodhuesit të asistojë në montimin e dekovilit me qëllim realizimin racional të proceseve të montimit të tij.

2.3.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Eskavator me zinxhire me kapacitet minimal 0.5m ³	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë me kapacitet minimal 1.5m ³	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul me vibrim me kapacitet minimal 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet minimal 10m ³	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet minimal 6m ³	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetonpompë me me hedhje 30m	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinç me kapacitet minimal 15 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Pirun me kapacitet minimal 4 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator (ngjeshje betoni) me kapacitet minimal 3,000 vib/min	2 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor ajri me kapacitet minimal 100lit/min	1 cope	Pronësi ose me qera

Matrapik me kapacitet minimal 60J (fuqi goditëse)	2 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike	500m ²	Pronësi ose me qera
Gru fleksibël	5 copë	Pronësi ose me qera
Bonko për lidhje hekuri	1 copë	Pronësi ose me qera
Karro dore	5 copë	Pronësi ose me qera
Kazma	10 copë	Pronësi ose me qera
Lopata	10 copë	Pronësi ose me qera

“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: çertifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;
Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të

prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe pajisjet, janë përcaktuar në raportin teknik të përgatitur nga projektuesi.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike- referuar relacionit teknik për punimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me qëllimin e hartimit të këtij projekti.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Njësia e Prokurimit.